

**PERMBLEDHJE JO TEKNIKE E  
VLERESIMIT PARAPRAK TE NDIKIMIT NE  
MJEDIS  
I AKTIVITETIT TE PRODHIMIT TE BARNAVE  
PER KAFSHET  
“IMI PHARMA”  
XHAFZOTAJ, SHIJAK, DURRES**



**ADMINISTRATOR: Z. GRIDI BOZDO**

**PERGATITUR NGA: “GREEN HOURS” SHPK**

**TIRANE, ME 12.04.2021**

## Permbledhje jo teknike

### Hyrje

Studio e konsulences “Green Hours” shpk eshte studio e paisur me Licence LN-7408-02-2014 per hartimin e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditim mjedisor, per hartimin e ekspertizave per probleme mjedisore dhe thirjen si ekspert per te vleresuar nje raport te vleresimit te ndikimit ne mjedis ose rezultatet e nje auditimi.

“Green Hours” shpk eshte e certifikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave sipas Vendimit Nr 3, Nr 197 regjistri, Nr 324 prot, date 20.04.2006.

Prane studios “Green Hours” shpk punon si drejtues teknik eksperti mjedisor Denis Harasani i paisur me Certifikate nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave me Nr 5116 Prot, Nr identifikues 143, date 08.07.2013.

“Green Hours” shpk eshte e regjistruar ne QKR dhe eshte e paisur me NIPT K61626009I

Me kerkese te perfaqesuesit ligjor z. Luan Kullolli, gjate periudhes Prill 2021, studjo e konsulences “Green Hours” shpk pergatiti Kerkesen per Kerkesen per Leje Mjedisore te Tipit B per aktivitetin e linjes per prodhimin e barnave per kafshe “IMI PHARMA”, me vendodhje ne njesine administrative Xhafzotaj, Bashkia Durres

**“IMI PHARMA” ka disa vite qe ushtron aktivitet prodhues dhe tregtar dhe bazuar ne kerkesat e legjislacionit shqiptar, ka kerkuar pergatitjen e dokumentacionit per tu paisur me Leje Mjedisore te Tipit B.**

Aktualisht, pronari (perfaqesuesi ligjor z. Gridi Bozo) ishte i impenjuar ne procesin e realizimit dhe krijimit te kushteve per pergatitjen e dokumentacionit te plote.

**Bazuar ne legjislacionin per mjedisin, duke i u referuar investimit te kryer, kapaciteteve magazinuese, teknologjise se rruajtjes, cilesise se aksesoreve e tj, mendojme qe subjekti permbush kriteret per paisjen me Leje Mjedisore te Tipit B**

Procesi i pergatitjes se kerkeses u realizua sipas hapave te me poshteme:

- Njohja me subjektin qe ushtron aktivitetin
- Njohja me objektin ku zhvillohet aktiviteti
- Njohja me problematiken e pergjitheshme dhe natyren e aktivitetit
- Njohje me projektet dhe funksionet e cdo objekti
- Identifikimin e ndikimit ne floren dhe faunen ekzistuese

- Identifikimi i mbetjeve dhe shkarkimeve te ndara sipas natyres
  - a. Mbetje te ngurta
  - b. Shkarkime ne ajer
  - c. Shkarkime ne uje
- Njohje me masat e mara per trajtimin e mbetjeve
- Identifikimi i mundesive per minimizimin e ndikimit

Rezultatet e ketij vleresimi paraqiten ne kete permbledhje jo teknike me qellimin final:

- Vleresimin e ndikimit ne flore e faun
- Vleresimin e ndikimit ne peisazh
- Vleresimin e bilancit te shkarkimeve ne ajer.
- Vleresimin e shkarkimeve ne ujrat siperfaqesore dhe nentokesore:
- Trajtimin mjedisor te mbetjeve te ngurta
- Hartimin e programit te monitorimit

### ***Vendodhja e instalimit***

Subjekti “IMI PHARMA”ndodhet ne krahun e djathte te autostrades (drejrimi Durres-Tirane) ne rrugen dytesore perpara Subjektit Delta Hotel & Events, rreth 600 m larg.

Objekti i “IMI PHARMA” eshte investim i ri. Ai eshte konceptuar ne menyre te tille qe te kryejne te gjitha funksionet duke filluar nga magazinimi i lendes se pare e deri ne amballazhim e magazinim te produktit te gatshem me cikel te mbyllur.

Teritori i ku eshte ndertuar “IMI PHARMA” eshte mjaft i pershtatshem per funksionimin e ketij aktiviteti pasi paraqet nje sere perpresish si:

- Nepermjet rruges dytesore te shtruar me asfalt, objekti lidhet me autostraden Durres-Tirane dhe rruget e tjera nacionale.
- Sistem perspektiv te furnizimit me uje (furnizohet me uje nga ujesjellesi)
- Sistem perspektiv te furnizimit me energji elektrike.

- Mundesi per zbatimin korekt te projektit
- Mundesi per ngritje dhe mirmbajtje te sistemit te kanalizimeve dhe shkarkimeve.

Pozicioni i “IMI PHARMA” ka te zgjidhura disa nga problemet me te rendesishme ne lidhje me anen funksionale si:

Largesi te mjaftueshme nga vendet e banuara.

Prane fuqise punetore.

Brenda nje teritori te studiuar nga ana urbanistike.

Prane rruges nacionale.

Larg zonave te mbrojtura, arkeologjike, shkollave, kopshteve, spitaleve etj.



### ***Kapacitetet prodhues***

Duke gjykuar nga mjetet ne dispozicion te shoqerise dhe teknologjise se perdorur, kapacitetet prodhuese te "IMI PHARMA" jane te tilla qe mund te rriten pertej nivelit te prodhimit te parashikuar. Shoqeria qe kete vit te pkonfeksionojë rreth 440 kg + 840 litra lende te pare

### ***Madhesia e objekteve***

Siperfaqja totale e prones eshte 4990 m<sup>2</sup>. Prona perbehet nga nje pjese dhe ka nr pasurie 157/184

Siperfaqja e sheshit te ndertimit 4990 m<sup>2</sup>.

Siperfaqja e ndertimit 3000 m<sup>2</sup>. Ndertesa ka nr pasurie 157/200<sup>ND</sup>

Siperfaqja totale e ndertimit 7727 m<sup>2</sup>.

Volumi i objektit 34800 m<sup>3</sup>.

### ***Bimesia dhe gjallesat***

Zona ku jane vendosur ambientet e "IMI PHARMA" ka qene zone rurale.

Perpara viteve 90 ne kete zone zhvillohej aktivitet bujqesor.

Aktualisht, ne zonat kufitare rreth 100 m ne veri zhvillohet aktivitet bujqesor.

Kultivohen kryesisht bimet e arave si grure, foragjere e tj.

Nuk rezulton faune e pasur. Nga gjallesat qe hasen me shpesh jane qente, macet, miu i arave, ndersa nga shpendet kryesisht arabelat, kumurite e tj.

Vlen te permendet qe nuk ka specie te rrezikuara apo te mara ne mbrojtje te vecante ne kete zone.

### ***Punesimi***

Ne IMI PHARMA aktualisht jane punesuar 4 punonjes te perhershem (2 administrate + 2 punetore) Ne periudha te caktuara do te angazhohen dhe punonjes te perkohshem.

Nga pikpamja sociale, zhvillimi i ketij aktiviteti eshte faktor per zbutjen e papunesise dhe burim te ardhurash per familjet qe jetojne duke punuar ne kete shoqeri.

### ***Efektet positive ne mjedis.***

Nga pikpamja e peisazhit, ndertesat e "IMI PHARMA" nuk luan ndonje rrol perkeqesues, perkundrazi, konceptimi arkitektonik i rrit vlerat.

Ndertesa e “IMI PHARMA” dhe e ambienteve ndihmese jane me konstrukcion plinta betoni dhe veshje mur tulle e vetrare xhami

Efektin pozitiv e shtojne sheshi perpara ndertesës dhe ruget e shtruara pereth, ambientet e gjelberta dhe pemet e mbjellura rreth e qark.

Ne kete kompleks si burim energjie perdoret energjia elektrike e siguruar kryesisht nga rrjeti elektrik. Ne raste shume te rralla energjia elektrike sigurohet nga gjeneratori.

Shkarkime ne ajer kemi ne rastet kur punon gjeneratori dhe nga karburanti i makinave. Duke patur parasysh kohen e perdorimit, kapacitetin prodhues, kohen e qendrimit te makinave per furnizim e tj, keto lloj shkarkimesh ne ajer nuk perbejne rrezik ndotje.

Shkarkimet e ujrave te bardha dhe te zeza jane te sistemuara nepermjet kanalizimeve, pusetave dhe derdhen ne nje depozite dekantuese dhe me pas ne sistemin e kanalizimeve te zones.

“IMI PHARMA” eshte e paisur me certificate sanitare. Ka ambiente per xhveshjen dhe larjen e personelit (Vec per te dy sekset), tualete (vec per te dy sekset), mence per personelin etj.

Ne objekr ekzistojne mjetet e mbrojtjes kunder zjarit, personeli eshte i instruktuar.

Zhurmat nuk perbejne problem shqetesues per banoret perreth per aresye te distancave nga shtepite e banimit, dhe te procesit teknologjik.

Ne impiantin e prodhimit te ilaceve dhe suplementeve zbatohen ne menyre rigoroze regullat higjeno sanitare.

### ***Efektet negative ne mjedis.***

Potencialisht, gjate aktivitetit te “IMI PHARMA” mund te hasim ne efekte negative ne mjedis si:

Ndotja siperfaqesore dhe e ujrave nentokesore si pasoje e difekteve te mundeshme ne rjetin e shkarkimeve te ujrave te zeza dhe te bardha.

Ndotja e mjedisit si pasoje e zhurmave qe mund te shkarkohen nga motorat dhe burite e makinave.

Ndotja e mjedisit nga mbeturinat e ngurta.

Ndotje e ajrit.

### ***Ndikimi ne siperfaqe dhe ujrat nentokesore.***

Vektoret kryesore te mundeshem te ndotjes se siperfaqes dhe ujrave nentokesore jane kanalizimet e ujrave te bardha dhe te zeza. Per rjedhoje reziku i ndotjes mund te vije nga fekalet dhe elementet ndotes te detergjenteve qe perdoren per pastrimin e ambienteve, makinerive, eneve, te tualeteve e tj.

### ***Ndikimi ne ajer.***

Megjithese praktikisht nuk ka rezik, ndotja e ajrit mund te vije nga djegja jo e rregullt e karburantit, gjeneratorit, makinave etj.

### ***Zhurmat***

Ne mjedisin perreth mund te behen problem shqetesues zhurmat qe vijne si rezultat i i ritjes se fluksit te makinave, i manovrimit dhe i burive.

Persa i perket zhurmave qe vijne si rezultat i aktivitetit, ato jane minimizuar si rezultat i investimeve qe jane kryer.(jane pershkruar me lart).

### ***Rastet aksidentale***

Zjaret mund te jene te pranishem

Aksidente

Te tjera te paparashikuara.

### **Masat e mara per minimizimin e pasojave negative.**

Me qellim minimizimin ne maksimum te efekteve negative mjedisore, qofte edhe potenciale, dhe ritjes se efekteve pozitive ne mjedis, administratori i linjes “IMI PHARMA”, Xhafzotaj, Durres, duhet te mare masa si me poshte.

#### ***1. Per ruajtjen nga ndotjet siperfaqesore dhe te ujrave nentokesore.***

Te survejtoje regullisht funksionimin e rrjetit te kanalizimeve te ujrave te bardha e te zeza.

Ti pastroje regullisht ato.

Te kryej dezinfektimin periodik te tyre.

Te mbaje te paster dhe te sistemuar ambjentet e jashteme te “IMI PHARMA”

Te mbjelle peme dhe te rise siperfaqen e ambjente te gjelberta ne teritorin e “IMI PHARMA”

#### ***2. Per trajtimin e mbetjeve te ngurta.***

Te seleksionioje mbetjet e ngurta sipas lloit te materjalit perpara largimit te tyre ne vend depozitim.

Ti depozitohet ato ne vendin e caktuar nga njesia administrative

#### ***4. Per minimizimin e zhurmave.***

Te reklamoje me mjete figurative (tabela, shtypshkrime etj) ndalimin e burive per makinat e klienteve.

#### ***5. Per rruajtjen e ajrit nga ndotjet***

Te mbaje ne kondicion teknik bokset, ambjentet e linjave teknologjike, sistemin e ventilimit etj.

#### ***6. Per eliminimin e rasteve aksidentale si zjare e tymra.***

Te instruktoje punonjesit per masat e mbrojtjes nga zjarri, te reklamoje kuadrin ligjor per mbrojtjen nga zjari, ndalimin e pirjes se duhanit e tj.

#### ***6. Per regullat e sigurimit teknik***

Te reklamoje ne vende te dukshme rregulloret e sigurimit teknik, te kryej ne menyre periodike instruktimin e punonjesve sipas afateve te percaktuara ne legjislacionin shqiptar etj.

### **Per monitorimin e vazhdueshem te ndotjeve.**

Pronari ose administratori detyrohet te njoftoje rregullisht Agjensine Rajonale te Mjedisit per cdo eventualitet dhe problem qe paraqet rrezik per ndotje te mundeshme te ambientit.

Pronari detyrohet te veje ne dijeni Agjensine Rajonale te Mjedisit per cdo ndryshim apo shtesa te aktivitetit qe mund te kene ndikime ne mjedis.

Monitorimi i ndotjeve dhe efekteve te ketij aktiviteti do te realizohet nga struktura te specializuara dhe te dhenat do te raportohen prane Agjensise Rajonale te Mjedisit ne perputhje me detyrimet qe rjedhin nga ligjet dhe rregulloret ne fuqi. Pronari eshte i detyruar te krijojte kushtet e nevojshme per monitorimin e sakte dhe te vazhdueshem.

Pronari detyrohet te zbatoje te gjitha detyrimet qe rjedhin nga ligji Nr 9010 date 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta", Ligjit Nr 9115 date 27.07.2003 " Per trajtimin mjedisor te ujrave te ndotura", Ligjit nr 8934 date 05.09.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit" si dhe gjithe legjislacionin shqiptar ne lidhje me mjedisin.



Per "Green Hours" shpk

Administratori

Dr. Bardhyl Qilimi

Tirane 12.04.2021



Eksperti

Denis Harasani

